



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 137, datë 07.06.2021

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 478, SERIA T20, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË “HEC ZALL XHUXHË” SH.P.K., ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 242, DATË 21.12.2020, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 5, gërma “a”, nenit 6 dhe nenit 7, të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.04.2017; nenit 15 dhe 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; pikës 5.1, të Kushteve të Licencës për Veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 07.06.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 87/1 prot., datë 03.06.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

**Konstatoi se:**

- Me vendimin nr. 242, datë 21.12.2020, bordi i ERE-s vendosi:
  1. Të licencojë shoqërinë “HEC ZALL XHUXHË” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar, me kushtin që shoqëria të depozitojë brenda 3 muajve nga marrja e këtij vendimi:
    - i. Vërtetimin për shlyerjen e tatim – taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore.
    - ii. Dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.
    - iii. Sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për t’u tregtuar në GWh / për pesë vitet e licencës së tregtimit të energjisë elektrike.
    - iv. Kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.
  2. Mos plotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.

- Në vijim të këtij licencimi me kusht, shoqëria ka depozituar në ERE Vërtetimin për shlyerjen e tatim - taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore duke plotësuar kështu kushtin e vendosur në pikën 1, gërma “i”, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 242/2020, si dhe ka paraqitur kërkesën për të shtyrë me 30 ditë afatin e plotësimit të dokumentacionit të mbetur ende pa plotësuar.
- Bazuar në dokumentacionin e depozituar nga shoqëria dhe në kërkesën e saj, me vendimin nr. 107, datë 22.04.2021 bordi i ERE-s ka vendosur që shoqëria të depozitojë në ERE brenda 60 ditëve, duke filluar ky afat nga data 28.03.2021, dokumentacionin si më poshtë:
  - Dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj).*
  - Sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për t’u tregtuar në GWh / për pesë vitet e licencës së tregtimit të energjisë elektrike.*
  - Kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.*
- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e bordit nr. 107/2021 me shkresën nr. 451/3 prot., datë 04.05.2021 dhe me shkresën nr. 451/4 prot., datë 18.05.2021, i ka rikujtuar asaj afatin për plotësimin e dokumentacionit, sipas përcaktimeve të vendimit të bordit nr. 107/2021, duke sjellë në vëmendje se mosplotësimi i dokumentacionit brenda datës 26.05.2021 do të përbëjë kusht për rishikimin e vendimit.
- Nuk rezulton që shoqëria të ketë kthyer përgjigje ndaj shkresave të ERE-s.
- Nga analiza e kryer rezulton se shoqëria nuk ka përmbushur brenda afatit kushtet e përcaktuara në vendimin e licencimit e po ashtu nuk ka dokumentuar në ERE përpjekjet e saj për përmbushjen e tyre.
- Në zbatim të nenit 7, të *Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017, shoqëria ka të drejtë të përgjigjet me shkrim brenda 30 ditëve nga marrja dijani e fillimit të kësaj procedure.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 478, seria T20, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “HEC ZALL XHUXHË” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 242, datë 21.12.2020, i ndryshuar.
2. Shoqëria mund të paraqesë argumentet e saj me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**